

UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT TË FLOTËS NË PORSCHE LEASING

I nderuar përdorues,

Dëshirojmë t'ju informojmë mbi rregullat bazë të funksionimit të konceptit të Menaxhimit të Flotës përmes shërbimeve të ofruara nga Porsche Leasing.

Shënim i rëndësishëm: Këto udhëzime vlejnë vetëm nëse shërbimi konkret është kontraktuar përmes Porsche Leasing.

Në aplikacion, në faqen Automjet – Karta Identifikuese e Flotës (Fleet ID Card), do të gjeni kartën e identifikimit që përdoret për të identifikuar automjetin kur futen në një qendër servisi ose kur kryhet kontrolli teknik.

Në faqen e parë të kartës gjenden informacionet për automjetin dhe përdoruesin, si dhe periudha e vlefshmërisë.

Në faqen e dytë të kartës gjenden numrat e kontaktit të Asistencës së Flotës për thirrje nga Shqipëria dhe jashtë vendit.

Në faqen e tretë të kartës listohen në detaje shërbimet e kontraktuara



Porsche Leasing SHPK.

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rrugs Monun | Kashar | Tiranë | Albania
Phone: +355 (04) 450 08 28 | Fax: +355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623006N Raiffeisen Bank ALB |

Nr. llogarie: 003740323 (EUR) | IBAN: AL63202110750000000003740323, Raiffeisen Bank



ASISTENCA E FLOTËS

- Për çdo defekt ose aksident rrugor që pengon vijimin e lëvizjes së automjetit, përdoruesi duhet të kontaktojë numrin e Asistencës së Flotës.
SHËNIM: Në rast aksidenti rrugor ose çdo dëmtimi tjetër të konstatuar në automjet, përdoruesi është i detyruar të njoftojë policinë për të marrë një raport zyrtar.
- Asistenca e Flotës, në rast nevoje, siguron: Shpëtimin me karroatrec deri te servisi i autorizuar më i afërt.
- Nëse është e mundur mund të sigurojë : riparimin e automjetit në vend, ndërrimin e gomave në vend, dorëzimin e çelësave dhe shërbime të tjera të ngjashme.



MIRËMBAJTJA E AUTOMJETIT

- Të gjitha automjetet mirëmbahen sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe vetëm në rrjetin e serviseve të autorizuar për markën e automjetit që përdorni.
- Automjetet shkojnë për servis të rregullt kur ndizet drita e servisit në panelin e komandës. Drita ndizet të paktën 1.000 km para servisimit të ardhshëm ose një muaj më parë.
- Në aplikacion, për automjetet VW, Audi, Seat dhe Skoda, në seksionin: **Konçesionar > Kërko servise** makinash, mund të gjeni të gjitha servisët e autorizuar në Shqipëri për markën e automjetit tuaj. Për të gjitha markat e tjera, në seksionin: **Konçesionar > Servise** për marka të huaja > Select Brand, zgjidhni markën që përdorni dhe do t'ju shfaqen të gjitha servisët partner të autorizuar. Duke vendosur qytetin në Specify a location, do t'ju shfaqen serviset më të afërta të atij qyteti.
- Përdoruesi është i detyruar të monitorojë të gjitha sinjalizimet e tjera në panelin e komandës që tregojnë probleme të tjera në automjet dhe të trajtojë automjetin me kujdes si një përdorues i mirë.
- Të gjitha defektet e automjetit duhet të raportohen te departamenti i brendshëm përgjegjës për flotën.
- Shkurtime të rëndësishme të intervaleve të servisimit nuk lejohen (lejohet shkurtimi deri në 1.000 km ose 30 ditë).
- Përdoruesi raporton defektet tek departamenti i brendshëm përgjegjës. Komunikimi i mëtejshëm (miratimi i punimeve, koordinimi, etj.) bëhet midis departamentit të brendshëm të Porsche Leasing dhe servisit.



MENAXHIMI I GOMAVE

- Në aplikacion, nën seksionin **"Vendndodhja e Gomave"**, do të shfaqen të dhënat e objektit ku ndodhen gomat tuaja. Ju mund të rezervoni orarin duke klikuar në website ose përmes numrit të telefonit të dhënë. Zëvendësimet sezonale të gomave, mund të kryhen vetëm pas marrjes së njoftimit nga ana jonë.
- Në rast dëmtimi të gomave gjatë udhëtimit, përdoruesi duhet të vendosi gomen rezerve. Për ndërrimin e gomës nga Asistenca e Flotës, përdoruesi është i detyruar të njoftojë departamentin e brendshëm përgjegjës ditën e punës pas ngjarjes, dhe departamenti do të informojë Porsche Leasing.

Porsche Leasing SHPK.

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rrugs Monun | Kashar | Tiranë | Albania
Phone: +355 (04) 450 08 28 | Fax: +355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623006N Raiffeisen Bank ALB |

Nr. llogarie: 003740323 (EUR) | IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

- Automjeteve do t'u sigurohet numri i kontraktuar i gomave sipas kontratës dhe km.
- Blerjen e gomave të reja e kryen Porsche Leasing në koordinim me serviset, në fillim të çdo sezoni nëse ka nevojë, ose gjatë vizitave të rregullta të servisimit, nëse servisi raporton gjendje të pakënaqshme të gomave.
- Organizimin e zëvendësimeve sezonale të gomave e kryen Porsche Leasing në bashkëpunim me departamentin e brendshëm përgjegjës për flotën, i cili merr njoftime të drejtëpërdrejta me emai.



REGJISTRIMI I AUTOMJETIT DHE KONTROLLI TEKNIK

- Regjistrimi i automjetit dhe pajisja me policën e sigurimit detyruet TPL, janë detyrë e Porsche Leasing.
- Pas marrjes së njoftimit, duhet të ndiqni udhëzimet, duke dërguar automjetin për inspektim teknik dhe duke dorëzuar në adresën: Porsche Leasing – Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 raportin e inspektimit teknik dhe lejen e qarkullimit.
- Në aplikacion, nën seksionin: Konçesionar - Kontrolli teknik, mund të gjeni listën e të gjitha qendrave të kontrollit teknik në Shqipëri.
- Të gjitha mjetet e reja të llojit autoveturë, ATP dhe motomjete, përjashtuar ambulancat dhe taksitë, të cilat regjistrohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, mund të qarkullojnë brenda vendit pa kryer kontrollin teknik për një afat 3-vjeçar nga data e regjistrimit për herë të parë.
- Për automjetet e përdorura, kontrolli teknik kryhet çdo dy vjet.
- Porsche Leasing kryen pagesen e taksave vjetore cdo vit.



SIGURIMI KASKO I AUTOMJETIT

- Automjeti është i mbuluar me sigurim kasko gjatë gjithë periudhës së qirasë operationale, dhe përgjegjësia për rinovimin e policës së kasko është e Porsche Leasing.
- Pajisja me policën Kasko dhe Green Card është detyrë e Porsche Leasing.



DËMET

- Për çdo aksident rrugor, përdoruesi është i detyruar të njoftojë policinë. Po ashtu, për çdo dëmtim të konstatuar në automjet, përdoruesi duhet të njoftojë policinë. Përjashtim bëhet vetëm në rastin kur dëmtohet vetëm xhami i përparmë i automjetit gjatë udhëtimit (në rast dëmtimi që kryhet me dashje, edhe ky rast kërkon raportim tek policia).
- Nëse dëmtimi bën të pamundur vijimin e udhëtimit, përdoruesi, duhet të kontaktojë Asistencën e Flotës.
- Nëse pas dëmtimit ndizet ndonjë dritë sinjalizuese ose nëse lëvizja e automjetit bëhet e vështirë, e pasigurt ose mund të shkaktojë dëmtime më të mëdha, përdoruesi duhet të kontaktojë Asistencën e Flotës.

Porsche Leasing SHPK.

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rrugs Monun | Kashar | Tiranë | Albania
Phone: +355 (04) 450 08 28 | Fax: +355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623006N Raiffeisen Bank ALB |

Nr. Ilogarie: 003740323 (EUR) | IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

- Për çdo pyetje lidhur me aksidentin rrugor, përdoruesi mund të kontaktojë Asistencën e Flotës. Përdoruesi është gjithashtu i detyruar të njoftojë departamentin e brendshëm përgjegjës, për dëmtimin e automjetit.
- Në aplikacion, nën seksionin: Shërbimet > Deklarata e shoferit për dëmin, përdoruesi duhet: Të plotësojë të gjitha të dhënat: të përshkruajë ngjarjen me detaje dhe saktë; të bashkëngjisë fotografi të automjetit të dëmtuar, lejes së qarkullimit, lejes së drejtimit të përdoruesit, letërnjoftimit, raportit të policisë ose shënimeve zyrtare nëse ekzistojnë, raportin evropian të aksidentit nëse është hartuar, fotografi të vendngjarjes.
- Në rast vjedhjes së automjetit, përdoruesi duhet të njoftojë policinë dhe departamentin e brendshëm përgjegjës të flotës. Në rast vjedhjeje, është e nevojshme të dorëzohen 2 kopjet e çelësave të automjetit dhe origjinali i lejes së qarkullimit.



AUTOMJET ZËVENDËSUES

- Përdoruesi fiton të drejtën për përdorimin e automjetit zëvendësues, me miratimin e departamentit të brendshëm përgjegjës të flotës, dhe vetëm kur automjeti i marrë me qira është jashtë shfrytëzimit për arsye objektive.
- Nëse rregullat e brendshme e lejojnë, përdoruesi mund të dërgojë kërkesë direkt përmes aplikacionit: **Shërbimet > Makina Zëvendësuese**, shton departamentin e brendshëm të flotës në kopje të email-it, plotëson fushat e shënuara me vija dhe dërgon kërkesën. Kërkesa për automjet zëvendësues, duhet të dërgohet të paktën 2 ditë pune para ngjarjes



MARRJA DHE DORËZIM I AUTOMJETIT

- Përdoruesi fiton të drejtën për përdorimin e këtij shërbimi me miratimin e departamentit të brendshëm përgjegjës të flotës, dhe vetëm kur automjeti i marrë me qira ka nevojë për një operacion si: servis, ndërrim gomash, kontroll teknik.
- Nëse rregullat e brendshme lejojnë, përdoruesi mund të dërgojë kërkesë direkt përmes aplikacionit. Shërbimet > Marrje dhe dorëzim autojeti (Pick-Up and Delivery), shton departamentin e brendshëm të flotës në kopje të email-it, plotëson fushat e shënuara me vija dhe dërgon kërkesën.
- Kërkesa për organizimin e marrjes dhe dorëzimit të automjetit duhet të dërgohet të paktën 2 ditë pune para ngjarjes.

Personat përgjegjës pranë Porsche Leasing, për çdo pyetje shtesë ose ndihmë gjatë përdorimit të automjetit janë:

Arnold Muçollari: arnold.mucollari.ext@porscheleasing.al | Tel: 069 601 0099

Erdi Kraja: erdi.kraja@porscheleasing.al | Tel: 069 704 1892

Faleminderit për bashkëpunimin,

Stafi Porsche Leasing

Porsche Leasing SHPK.

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rrugs Monun | Kashar | Tiranë | Albania
Phone: +355 (04) 450 08 28 | Fax: +355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623006N Raiffeisen Bank ALB |

Nr. Ilogarie: 003740323 (EUR) | IBAN: AL63202110750000000003740323, Raiffeisen Bank